



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:071217

Datë: 20.05.2019

Numri i dokumentit: 00318208

P.nr. 11/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me procesmbajtësen Donika Latifi, në çështjen penale kundër të pandehurit S. R. nga Gjilani, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.1860/2019, të datës 26.11.2019, jashtë seance dhe sipas detyrës zyrtare, me datën 20.05.2019, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HUDHET poshtë aktakauza e Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.1860/2019, të datës 26.11.2019.
- II. PUSHOHET procedura penale ndaj të të pandehurit S. R. nga Gjilani, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, për shkak se vepra penale për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës me numër 06/L-074, të hyrë në fuqi me datë 14.04.2019.
- III. I dëmtuari K. R., nga fshati Zhiti, Komuna e Vitisë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.
- IV. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 24.12.2018, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1860/2019, kundër të pandehurit S. R. nga Gjilani, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.

Duke u bazuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës me numër 06/L-074, të datës 13.12.2018, të miratuar nga ana e Kuvendit i Republikës së Kosovës ndërsa i hyrë në fuqi me datë 14.04.2019, gjykata gjeti se veprimet inkriminuese të të pandehurit të lartcekur, nuk përbëjnë vepër penale sipas nenit 370 paragrafi 1 të KPRK-ës, ngase në këtë nen thuhet se *“Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet*

*me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”, çka nënkupton se veprimet të cilat kanë pasur si pasojë shkaktimin e lëndimit të lehtë trupor të kryer me rastin e shkeljes së ligjit mbi trafikun publik apo transportit rrugor e të cilat kanë qenë të parapara në nenin 378 paragrafi 1 të KPRK-ës së shfuqizuar dhe për të cilën vepër akuzohet i pandehuri, sipas nenit 370 paragrafi 1 të KPRK-ës nuk përbëjnë vepër penale gjithashtu duke pasur parasysh se sipas nenit 3 paragrafi 2 të KPRK-ës në të cilin thuhet se “Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm”, si dhe faktin se zbatimi i veprimit retroaktiv të ligjit është obligim i gjykatës dhe se me rastin e ndryshimit të ligjit duhet të zbatohet ligji më i favorshëm për të pandehurin, gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret veprimet inkriminuese të parapara në nenin 378 paragrafi 1 të KPRK-ës së shfuqizuar (pëkatësisht shkaktimi i lëndimit të lehtë trupor me rastin e shkeljes së ligjit mbi trafikun publik apo transportit rrugor) sipas kodit të ri penal nuk paraqesin vepër penale dhe si rrjedhojë ndaj kryesve të këtyre veprave penale më nuk mund të ndërmiret ndjekja penale dhe as tiu shqiptohet dënimi i paraparë ligjor.*

Andaj gjykata në bazë të nenit 253 paragrafi 1 pika 1.1 të KPP-së dhe nenit 3 paragrafi 2 të KPRK-ës, vendosi që të hudhë poshtë aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ndaj të pandehurit të lartcekur të pushohet procedura penale për veprën penale e cila i vihet në barrë.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.11/19, më datë 20.05.2019

Procesmbajtësja,  
Donika Latifi

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:**Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa ushtrohet nëpërmes kësaj gjykate.